

**PËLLUMB XHUFI****SKËNDERBEU DHE ALFONSI V I NAPOLIT: VASAL APO ALEAT?**

Edhe pas më shumë se 500-vjetësh nga vdekja e tij, figura e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut vazhdon të tërheqë interesin e historianëve të Mesjetës, pjesa më e madhe e të cilëve, sa më shumë është zgjeruar baza dokumentare, bashkohen në përcaktimin e heroit shqiptar si një figurë qendrore në përplasjet e Perëndimit të krishterë me fuqinë e re osmane, në mes të shek. XV, si udhëheqës i një kryengritjeje dhe i një lufte epokale mbarëshqiptare dhe si krijuesi i një shteti të vërtetë kombëtar shqiptar në Mesjetë. Mes tyre radhiten historianë të njohur shqiptarë, duke filluar nga F. S. Noli e A. Gegaj, e për të përfunduar tek më të rinjtë, si A. Buda, K. Frashëri e K. Biçoku<sup>1</sup>. Por në pozicione të ngjashme qëndrojnë edhe emra të mëdhenj të historiografisë evropiane, si J. Ph. Fallmerayer, J. G. von Hahn, F. Babinger, G. Ostrogorsky, R. Cessi, F. Pall, A. Ducellier, etj.<sup>2</sup> Në të kundërtën, së fundi, historiani O. J. Schmitt,

<sup>1</sup> “Gjergj Kastrioti Skënderbeu (1405-1468)”, në: Fan Noli, *Vepra*, vëll. 4, Tiranë: 1989; Athanas Gegaj, *L’Albanie et l’invasion turque au XV<sup>e</sup> siècle*, Paris (Louvain): 1937; Aleks Buda, “Georges Kastriote-Skanderbeg et son époque”, në: *Deuxième Conférence des Études Albanologiques*, Tirana 12-18 janvier 1968, Tirana: 1969, f. 19-50; Kristo Frashëri, *Skënderbeu. Jeta dhe vepra*, Tiranë: “Toena”, 2002, f. 308-316; Kasem Biçoku, *Për Skënderbeun*, Tiranë: “Botimpex”, 2005, f. 302-315.

<sup>2</sup> Jacob Ph. Fallmerayer, *Das Albanische Element in Griechenland*, III. Abteilung. Abhandlungen der königlich-bayerischen Akademie der Wissenschaften, Historische Classe, vol. 9, Abteilung 1, München: 1860; Johan G. von Hahn, *Albanesische Studien*, Jena: “F. Mauke Verlag”, 1854, f. 326-327; Franz Babinger, *Maometto il Conquistatore e il suo tempo*, Torino, “Einaudi”, 1967; F. Babinger, “Arianit Komneni, vjehri i Skënderbeut”, në: *Konferenca e Parë e Studimeve Albanologjike*, Tiranë 15-21 nëndor 1962, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Tiranë: 1965, f. 476-485; Georg Ostrogorsky, *Storia dell’Impero bizantino*, Torino: “Einaudi”, 1968, f. 504-505; Roberto Cessi, *Storia della Repubblica di Venezia*, vëll. I, Milano: “Principato Ed.”, 1968, f. 408 (“*L’onore di impedire al Turco l’accesso all’Adriatico e la temuta invasione della penisola era lasciato all’eroismo nazionale albanese: ne era ispiratore Giovanni Castriota-Skanderbeg*”);

ka dashur ta shohë epokën skënderbejane si një luftë me karakter të kufizuar e lokal, e frymëzuar nga motive thjesht egoiste dhe të hakmarrjes të prijësit të saj, që si e tillë qe e padobishme, e rrënoi Shqipërinë dhe përcaktoi negativisht historinë e mëtejshme të saj<sup>3</sup>. Vlen të thuhet, se idetë e Schmitt, që kanë trazuar keq opinionin shkencor dhe atë jashtë shkencor brenda dhe jashtë Shqipërisë, janë një riprodhim *tale quale* i vlerësimeve episodike për Skënderbeun të bëra që në shek. XVIII nga historiani anglez Edward Gibbon, të cilin Schmitt, për habinë tonë, nuk e citon asnjëherë<sup>4</sup>.

Gjithsesi, inkuadrimi i saktë i veprës dhe i rolit historik të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, është i rëndësishëm edhe për të vlerësuar drejt edhe variabla të tjera të drejtpërdrejta të tij, siç është, në rastin tonë, ai i marrëdhënieve ndërkombëtare të Skënderbeut, dhe më ngushtësisht, i marrëdhënieve me Mbretërinë e Napolit.

Në mes të shek. XV, midis Gjergj Kastriot Skënderbeut dhe mbretit Alfons V i Aragonës e i Napolit, u vendos një lidhje e ngushtë<sup>5</sup>. Bazë e

Francisco Pall, "I rapporti italo-albanesi intorno alla metà del secolo XV", në: *Archivio Storico per le Province Napoletane*, III serie, vol. 4 (1965), f. 123-150; F. Pall, "Skanderbeg et Janco de Hunedoara", në: *Deuxième Conférence des Études Albanologiques*, Tirana: 1969, f. 87-104; Peter F. Sugar, *Southeastern Europe under Ottoman rule, 1354-1808*, bot. shqip, Tiranë: "Dituria", 2007, f. 74-75; Alain Ducellier, "La façade maritime de la principauté des Kastriote de la fin du XIV<sup>e</sup> siècle à la mort de Skanderbeg", në: *Deuxième Conférence des Études Albanologiques*, Tirana: 1969, f. 143-163; A. Ducellier, *Byzance et le monde orthodoxe*, Paris: "Armand Coplin", 1986, f. 435.

<sup>3</sup> Oliver J. Schmitt, *Skënderbeu*, Tiranë: "K&B", 2008, f. 457-478; O. J. Schmitt, "Skanderbeg-eine Reinterpretation", në: *The Living Skanderbeg: The Albanian Hero between Myth and History*, bot. Monica Genesin, J. Matzinger, G. Vallone, Hamburg: "Verlag Dr. Kovač", 2010, f. 237-244.

<sup>4</sup> Edward Gibbon, *Decadenza e caduta dell'impero romano*, vëll. VI, Roma: "Newton Compton", 1973, f. 510-513. Shih për këtë edhe: Nicola Jorga, *Brève histoire de l'Albanie et du peuple albanais*, Bucarest: 1919, f. 45; William L. Langer, *An Encyclopedia of World History*, Boston: 1940, f. 332; David Abulafia, *I regni del Mediterraneo occidentale dal 1200 al 1500*, Bari: 1999, f. 222.

<sup>5</sup> Shih: C. Marinescu, "Alphons V, roi d'Aragon et de Naples et l'Albanie de Scanderbeg", në: *Mélanges de l'École Roumaine*, Paris (Gamber): 1923; F. Cerone, "La politica orientale di Alfonso di Aragona", në: *Archivio Storico per le Province Napoletane* 27/28 (1902); F. Pall, "Renseignements inédits sur la participation albanaise à la guerre de Naples (1459-1463)", në: *Actes du premier Congrès*

kësaj marrëdhënie ishte sa interesi i përbashkët i përballimit të invazionit osman, aq edhe vetëdija e lidhjeve historike që kishin ekzistuar mes sovranëve të Italisë së Jugut dhe vendit të Arbrit. Mbi natyrën e këtij raporti mes Alfonsit të Napolit e Gjergj Kastrioti Skënderbeut është debatuar gjatë nga historiografia shqiptare dhe ajo e huaj. E megjithatë, edhe sot shumëkush i kthehet pyetjes: a ishin marrëdhëniet mes Alfonsit e Skënderbeut si marrëdhënie mes kryezotit e vasalit, apo ishin ato marrëdhënie aleance e bashkëpunimi mes sovranësh. Duke anuar vendosmërisht për këtë opsion të dytë, do të donim të parashtronim me këtë rast edhe ndonjë argument shtesë.

Në fakt, Skënderbeu u bë, në një farë mënyre, vasal i Napolit. Në vitin 1464, në shenjë mirënjohje për ndihmën që Skënderbeu i kishte dhënë në vitet 1460-1461 kundër fisnikëve të grupimit anzhuin<sup>6</sup>, mbreti Ferrante i dhuroi atij feudet e San Giovanni Rotondo e të Monte Sant'Angelo në Gargano. Në 14 prill 1464, midis Skënderbeut dhe mbretit Ferrante të Napolit u përmyll një kontratë feudale, e cila u kurorëzua me ceremoninë e betimit e të homazhit feudal<sup>7</sup>. Me këtë, Kastrioti kthehej *de jure* në një vasal të mbretit. Dhënia e feudit dhe ceremonia pasuese e betimit dhe e homazhit feudal, u krye sipas të gjitha rregullave të së drejtës feudale. Jo rastësisht, në këtë kontratë feudale përmenden me emër Karl I e Karl II Anzhu<sup>8</sup>. Anzhuinët kishin qenë dhe vazhdonin të ishin armiqtë më të egër të shtëpisë Aragona, dhe si të tillë do të meritonin një *damnatio memoriae*. Por Anzhuinët e veçanërisht Karli I e Karli II Anzhu, gëzonin dy avantazhe, që në rastin konkret nuk mund të injoroheshin: u kishte takuar atyre të sistemonin përfundimisht të

---

*Internationale d'Études Balkaniques et Sud-Est Européennes*, vëll. 3 (Histoire), Bucuresht: 1966, f. 469-475; O. J. Schmitt, *Skënderbeu*, f. 279-314.

<sup>6</sup> “*ita rebus nostris ac partibus favit ut merito sua virtute solus effectus ut nostre operate victoriae retributionem condignam ac pro impensis servitiis, gratitudinem nostram erga eum ostendere omnino debeamus*”, Gennaro M. Monti, *La spedizione in Puglia di Giorgio Castriota Scanderbeg*, Bari: 1940, f. 34.

<sup>7</sup> “*Illustris Dominus Georgius Castrioti dictus Scanderbech Albanie dominus ac factus novus dominus terrarum Montis Sancti Angeli et Sancti Joannis Rotundi personaliter prestitit in manibus domini Regis in forma sollempni et consueta ligium homagium et fidelitatis debite servande sacramentum*”, shih: G. M. Monti, *La spedizione in Puglia*, f. 34-35.

<sup>8</sup> *Po aty*, f. 35.

drejtën feudale të Mbretërisë së Napolit<sup>9</sup>, kishin qenë gjithashtu ata pararendësit e krijimit të një lidhjeje të qëndrueshme midis dy anëve të Adriatikut<sup>10</sup>.

Kështu, duket sikur me marrëveshjen feudale të 14 prillit 1464, Skënderbeu u bë një vasal i vërtetë i mbretit Ferrante. Mekanizmi që bëri të mundur kalimin në këtë status të ri ishte dhurimi i feudeve të San Giovanni Rotondo e të San Angelo. Por, deri tani askush nuk ka evidentuar faktin që ky raport feudal midis Skënderbeut e Ferrantes vllente vetëm në territorin e Mbretërisë së Napolit. Përfituesi i feudit, Skënderbeu, ishte një vasal i dhuruesit të feudit, Ferrantes, dhe i detyrohej atij vetëm brendapërbrenda territorit napoletan. Për analogji, kujtojmë rastin e mbretërve të Anglisë, të cilët ishin posedues të feudit të Akuitanës, dhe në këtë cilësi konsideroheshin vasalë të mbretit të Francës, por kuptohet, vetëm kur u takonte të ndodheshin në territorin francez<sup>11</sup>. Në të kundërtën, në Shqipëri, midis Skënderbeut e Ferrantes vepronte një tjetër lidhje. Aty, Skënderbeu nuk ishte në rolin e një vasali feudal në raport me mbretin e Napolit.

Nga ana tjetër, kontrata feudale e vitit 1464 nuk implikonte Skënderbeun, si *dominus Albaniae*, por implikonte thjesht personin dhe familjen e tij. Akti i marrjes në dorëzim i dy feudeve në Gargano, ishte një akt përgjegjësie i Skënderbeut ndaj familjes së tij. I ndërgjegjshëm për rënien e afërme të kështjellës shqiptare, Skënderbeu, ashtu si shumë krerë të tjerë shqiptarë, mendoi që së paku t'i siguronte një të ardhme të sigurtë familjes së tij aty ku më së shumti çmohej kontributi i tij luftarak, në Mbretërinë e Napolit.

Në fakt, nuk ishte Skënderbeu vetë, por familja e tij ajo që i ndërtoi marrëdhëniet me Kurorën napoletane në bazë të marrëveshjes së 1464, nga momenti kur gruaja dhe djali i Heroit u vendosën në Mbretërinë e

<sup>9</sup> E cila, gjithësesi, ishte hartuar për herë të parë nga dinastia Normane dhe nga ajo Hohenstaufen, shih: G. Vallone, *Istituzioni feudali dell'Italia Meridionale*, Roma: 1999, f. 97-128.

<sup>10</sup> A. Ducellier, "La façade maritime de l'Albanie au Moyen Âge ...", f. 230-300; Pëllumb Xhufi, "L'aggancio all'Est: Manfredi Hohenstaufen in Albania", në: Laura Balletto (bot.), *Oriente e Occidente tra medioevo ed età moderna*, vëll. II, Genova: 1997, f. 1233-1256; Pëllumb Xhufi, *Dilemat e Arbërit*, Tiranë: "Pegi", 2006, f. 89-172.

<sup>11</sup> Henry Pirenne, *Storia d'Europa*, Firenze: 1967, f. 182-185; K. O. Morgan, *Storia d'Inghilterra*, Bologna: 2001, f. 117.

Napolit<sup>12</sup>. Për sa i përket Skënderbeut, jo thjesht si kreu i familjes së Kastriotëve, por si zot i Shqipërisë (*dominus Albaniae*), në këtë cilësi ky i kishte formalizuar marrëdhëniet me Napolin vite më parë. Në 26 mars 1451 përfaqësuesit e Gjergj Kastriotit kishin nënshkruar me mbretin Alfons V i Aragonës e i Napolit traktatin e njohur të Gaetës<sup>13</sup>. Ky dokument formoi bazën juridike, mbi të cilën u ngritën marrëdhëniet mes Skënderbeut dhe kurorës së Napolit. Mbi përmbajtjen e këtij dokumenti është diskutuar gjatë. Kundrejt rezervave të historiografisë së vjetër e të re shqiptare<sup>14</sup>, historianë të huaj, kush më shumë e kush më pak, kanë mbrojtur idenë, se Traktati i Gaetës e ktheu Skënderbeun në një vasal të Alfonsit V<sup>15</sup>. Duke qenë edhe ne në një mendje me të gjithë ata që e konsiderojnë të pavërtetë vasalizimin e Skënderbeut nëpërmjet Traktatit të Gaetës<sup>16</sup>, do të donim me këtë rast të thonim mendimin tonë, me shpresën se po sjellim elementë të rinj analize.

Traktati lindi nën trysinë pushtuese të fuqisë osmane dhe që të dy, Alfonsi dhe Skënderbeu, ishin të interesuar ta ndalnin hovin e saj në kufijtë shqiptarë. Në Napoli, ashtu si edhe në oborret e tjera të Evropës, e dinin mirë se *finis Albaniae* do të thoshte gjithashtu edhe *finis Italiae*<sup>17</sup>.

<sup>12</sup> G. M. Monti, *La spedizione in Puglia*, f. 42-44; Paolo Petta, *Despota d'Epiro e principi di Macedonia*, Lecce: "Argos" 2000, f. 27-39; Giancarlo Vallone, *Periodha pas Skënderbeut*, Lecce: 2008, f. 26-38, 103-117.

<sup>13</sup> Teksti tek: Jovan Radonić, *Durađ Kastriot Skenderbeg i Arbanija u XV veku*, Beograd: 1942, f. 23-24.

<sup>14</sup> F. Noli, *Gjergj Kastrioti Skënderbeu*, f. 29-292; A. Buda, *Géorge Castriote Scanderbeg et son époque*, f. 42.

<sup>15</sup> Për këtë gjë duket fare i bindur Schmitt, shih: O. J. Schmitt, *Skënderbeu*, f. 279. Khs. C. Marinescu, *Alphonse V, roi d'Aragon et de Naples, et l'Albanie de Skanderbeg*, *Mélanges de l'École Roumaine en France*, 1, 1923, f. 42-45; F. Pall, "Marino Barlezio, uno storico umanista", në: *Mélanges d'histoire générale*, Bucarest: 1938, f. 92.

<sup>16</sup> K. Frashëri, në: *Historia e Shqipërisë*, vëll. I, Tiranë, 1959, f. 294-295; K. Frashëri, *Skënderbeu, jeta dhe vepra*, f. 312-316; K. Biçoku, *Për Skënderbeun*, f. 305-309.

<sup>17</sup> Senati për të dërguarin e vet pranë Papës, 7 qershor 1466: "*nos quoque nunciamus vobis manifesta et horrenda pericula occurrentia in dictis partibus Albanie que cum quotidie magis excreverint et excrescant sicut prefata regia maiestas eidem summo pontifici nunciavit certissimum teneri debet quod non solum concernunt ruinam et escidium Albanie verum Italie et christianitatis nisi tanto furori validis et celerrimis provisionibus occurratur*", shih: O. J. Schmitt, *Actes inédits concernant Venise, ses possessions albanaises et ses relations avec*

Në vështrim të krijimit të një barriere përkundrejt daljes në det të ushtrive osmane, mbreti napoletan ishte urgjentisht i interesuar që në Shqipëri, veçanërisht në traktin nevralgjik të saj që përputhej me rrugën e vjetër Egnatia që nixirte në portet e Durrësit e të Vlorës, të mund të ndërtonte me Skënderbeun dhe me krerë të tjerë shqiptarë një sistem aleancash, i cili në rrethanat e dhëna, të mund të realizonte *pa vonesë* komponentin ushtarak të një kontrate feudale. Siç do të shohim, zbatimi në terren vetëm i bashkëpunimit ushtarak, edhe ky i pamjaftueshëm dhe me ndërprerje, e ktheu Traktatin e Gaetës më shumë në një aleancë ushtarake, se sa në një kontratë të vërtetë detyrimesh e të drejtash feudale. Shumë shumë, Traktati i Gaetës ngjan me skicën e parë të një marrëdhënieje, e cila nxitoi të materializohej vetëm në komponentin luftarak, dhe që vetëm në rrethana të ndryshuara do të mund të shndërrohej në një lidhje të vërtetë të natyrës feudale<sup>18</sup>.

---

*Skanderbeg entre 1464 et 1468*, në: “*Turcica*” 31(1999), f. 277. Krhs. me tekstin e letrës që iu dërgua po atë ditë mbretit Ferrante: “*quod cum Magnificus Scandarbegus et res Albanie et per consequens christianitatis in maximo periculo constitute sint*”, O. J. Schmitt, *Actes inédits concernant Venise, ses possessions albanaises et ses relations avec Skanderbeg entre 1464 et 1468*, f. 276. “*Et se io fosse spontato, certamente Italia se ne sentiria et per ventura quello dominio, che voi dicite essere vostro, seria loro (dei Turchi, P. Xh.)*”: me këto fjalë të hidhura e jo-diplomatike e zbrazti Skënderbeu inatin e tij ndaj princit fodull e përcmues të Tarentit, Xhovani Orsinit. Shih: J. Radonić, *Đurađ Kastriot Skenderbeg i Arbanija u XV veku*, f. 120. Shih edhe te: G.M. Monti, *La spedizione in Puglia*, f. 31.

<sup>18</sup> Bie menjëherë në sy, se Skënderbeu duhet t’i plotësonte detyrimet e tij feudale vetëm “në kohë më të mira”: vetëm pas fashitjes së plotë të rrezikut osman (d.m.th. *asnjëherë*), Skënderbeu duhej të udhëtonte drejt Napolit, ku do të bënte homazhin e besnikërisë dhe vetëm atëherë do të duhej, gjithshu, të paguante një tribut të papërcaktuar (... *e caciato for a lo dicto S<sup>r</sup> de le mane de li Turchi, lo prefato S<sup>r</sup> Giorgio venera personaliter a li piedi de la dita M<sup>ta</sup> douuncha ordenara et li prestara juramento et omaggio de fidelita et de vasallagio...Item isso S<sup>r</sup> Giorgio et tucti li soi parenti daranno et pagaranno ciascuno anno a la prefata M<sup>ta</sup> lo tributo o heraci*). Sigurisht, Skënderbeu nuk e bëri kurrë betimin feudal dhe nuk pagoi kurrë ndonjë çfarëdolloj tributi. Në të kundërtën, Skënderbeu mori nga Napoli një pagë vjetore prej 1500 *dukatash*. Shih: J. Radonić, *Đurađ Kastriot Skenderbeg*, f. 23; C. Marinesco, *Alphons V, roi d’Aragonet de Naples et l’Albanie de Scanderbeg*, f. 79; A. Gegaj, *L’Albanie et l’invasion turc au XV<sup>e</sup> siècle*, Paris: 1937, f. 30,85; F. Pall, “Marino Barlezio, uno storico umanista”, në: *Mélanges d’histoire générale*, Bucarest: 1938, f. 91; F. Noli, *Gjergj Kastrioti Skënderbeu*, f. 292; K. Frashëri, *Skënderbeu, jeta dhe vepra*, f. 313-316.

Nëse Alfonsi i Napolit ishte atë moment historik i interesuar për marrëdhënie të ngushta me shqiptarët, akoma më shumë se ai ishin shqiptarët të interesuar që të shpluhurosnin e të ripërtërinin një marrëdhënie, të cilën ata e kishin patur me Mbretërinë e Siqilisë, që nga koha e dinastisë normane. Nëpërmjet një lidhje preferenciale me Napolin, Skënderbeu e princërit e tjerë shqiptarë, llogarisnin të përfshiheshin në sistemin e lidhjeve që Aragonat e Napolit kishin ndërtuar me fuqi të tjera italice e evropiane dhe t'i tërhiqnin ata të gjithë në luftën e tyre antiosmane. Në këtë kuptim, me Skënderbeun e krerët e tjerë shqiptarë, nga njëra anë, dhe mbretin Alfons, nga ana tjetër, po përsëritej një histori tashmë e njohur. Midis shek. XIII-XIV, brenda kuadrit të një raporti në dukje feudal, mbretërit anzhuinë të Siqilisë u mbajtën si sovranë e protektorë të krerëve feudale shqiptarë, të cilët, nga ana e tyre, paraqiteshin si vasalë e të mbrojtur (klientë) të të parëve<sup>19</sup>.

Nëse do t'i qëndronim thjesht deklarimeve të shprehura nga protagonistët e Traktatit të Gaetës, na duhet të pranojmë që vet Skënderbeu, në ndonjë rast, kujdeset të reklamojë lidhjet e tij me kurorën e Napolit, si lidhje vasal-kryezot. Kështu, në letrën për kundërshtarin e Aragonasve të Napolit, kontin Xhovani Orsini, të 31 tetorit 1460, Skënderbeu pohon se ai e ndërmori fushatën e tij në Apuli, në përmbushje të urdhërave të mbretit Ferrante (*per potere satisfaire ali comandamenti del mio Sig<sup>re</sup> Re Ferrando*)<sup>20</sup>. Por, në të njëjtën ditë ai i

---

<sup>19</sup> Por megjithë përpjekjet e anzhuinëve për t'i dhënë një përmbajtje konkrete një raporti feudal, të mbetur deri atëherë fiktiv, kjo nuk ndodhi dhe deri tani ne nuk kemi asnjë provë që të tregojë se ndonjëri prej fisnikëve shqiptarë kreu në ata shekuj ritualin e kryerjes së betimit e të homazhit feudal, apo të shlyerjes së detyrimeve feudale, në raport me sovranët e tyre të pretenduar të Napolit. Shih: P. Xhufi, *Dilemat e Arbërit*, f. 141-147, 150-153. Në të njëjtën kohë, për shkak të qëndresës së fisnikërisë vendase, Anzhuinët hoqën dorë edhe në More nga pretendimi për të marrë homazhin dhe betimin e besnikërisë. Shih: Jean Lognon, *Livre de la conquête de la princée de l'Amorée: Chronique de Morée (1204-1305)*, Paris: 1911, kap. 542; David Jacoby, *La féodalité en Grèce médiévale. Les Assises de Romanie*, Paris: 1971, f. 45.

<sup>20</sup> Kështu, në letrën për kundërshtarin e tij, kontin Giovanni Orsini, në 31 tetor 1460, Skënderbeu përmend disa elemente të marrëdhënieve të tij me kurorën e Napolit, që ngjajnë me ato të një vasali. Vetë fushata e tij në Italinë e Jugut qënkish bërë me urdhër të Ferrantes (*per potere satisfaire ali comandamenti del mio Sig<sup>re</sup> Re Ferrando*). Por, të njëjtën ditë ai i shkruan mbretit Ferrante, ku veç të tjerash na informon, se vendimin për fushatën italiane e kishte marrë ai vetë, me vullnetin e

dërgoi letër edhe vetë mbretit Ferrante, ku qartazi pohon se vendimin për fushatën italice e mori ai vetë, pasi, sqaron ai, “një burrë fisnik nuk ka nevojë ta ftojnë e ta lusin për t’i shkuar në ndihmë një të afërmi apo një miku të tij”. Pra, Skënderbeu i drejtohet Ferrantes jo sikur ky të ishte protektori e kryezoti i tij, por si të ishte thjesht një mik e i afërm. Në fakt, në këtë letër Skënderbeu i trajton marrëdhëniet e tij me vetë Ferranten dhe me të atin e tij, Alfonsin, në një mënyrë, po themi, të shkujdesur, informale, miqësore e familjare<sup>21</sup>. Një marrëdhënie e tillë, më shumë se në institucionin feudal të vasalitetit, do të gjente vend në institucionin parafeudal të *commendatio*-s (rekomandimit), që mbijetonte që nga kohët e hershme të feudalizmit. Në fakt, në 22 shkurt 1454, i dërguari milanez „Sceva de Curte i shkruante dukës Sforza, se kishte dëgjuar të thuhej që Skënderbeu “ishte bërë një i rekomanduar i mbretit të Aragonës” (*e dicese chel s’è facto raccomandato de esso re d’Aragona*). Se ç’ndryshim thelbësor ekzistonte midis një vasali e një të rekomanduari, këtë na e tregon më së miri rasti i Muzak Topisë, i cili cilësohet diku si “*grande amico e raccomandato*“ i Venedikut, gjë që përjashton prerazi një raport vasaliteti me Republikën e Shën Markut. Ndryshimin e madh midis një vasali dhe një të rekomanduari na e konfirmon edhe një letër e vetë Alfonsit V për Skënderbeun e 16 qershorit 1456, ku ai e lut heroin shqiptar të pranojë si të rekomanduar fisnikun Simon Zenebishi dhe vasalët e tij (*ve pregamo...vogliate debiate haber per recomandato lo magnifico Simoni Gimbisi e soy vassalli*)<sup>22</sup>. Ndryshe nga lidhja e mirëfilltë feudale, që e bënte vasalin një njeri të kryezotit, rekomandimi krijonte një marrëdhënie preferenciale mes dy subjekteve. Në rastin e Skënderbeut e të mbretërve të Napolit, të dhënat dokumentare insistojnë shumë më tepër mbi aspektin afektiv, paternalist, mbi ndjenjën e nderit e

---

vet, “pasi një burrë i vyrtytshëm nuk pret ta ftojnë apo ta lusin, që t’i shkojë në ndihmë një miku a të afërmi të tij”. Shih: J. Radonić, *Đurađ Kastriot Skenderbeg*, f. 121; G. M. Monti, *La spedizione in Puglia*, f. 32, 33; O. J. Schmitt, *Skënderbeu*, f. 279, 313.

<sup>21</sup> Shih sidomos letrën për mbretin Ferrante të datës 31 tetor 1460, J. Radonić, *Đurađ Kastriot, Skenderbeg*, f. 121.

<sup>22</sup> *Po aty*, f. 43, 57, 67; krhs. M. Barleti, *Historia e Skënderbeut*, Tiranë: 1967, f. 284, 314, 397, 418-421; Marc Bloch, *La società feudale*, Torino: “Einaudi”, 1976, f. 176-177.

të respektit të birit ndaj atit e të atit ndaj birit, se sa mbi premisa ekonomike e ligjore tipike për një lidhje feudale<sup>23</sup>.

Sigurisht, Alfonsi V e mori seriozisht çështjen e sovranitetit të tij mbi Skënderbeun dhe shtetin e tij, dhe në ndonjë rast u përpoq të merrte pozat e një kryezoti të vërtetë në raport me Skënderbeun. Menjëherë pas nënshkrimit të Traktatit të Gaetës, ai i dërgoi Skënderbeut disa ngarkesa me ushqime, madje në një rast i dërgoi edhe një “*petza di broccato*” të çmuar<sup>24</sup>. Me këtë gjest Alfonsi kryente një detyrim prej kryezoti feudal, por që gjithsesi lidhej me fillimet e feudalizmit, kur kryezoti kishte për detyrë të kujdesej për ushqimin dhe veshjen e njerëzve (klientëve) të tij<sup>25</sup>. Por, kjo nuk mund të fshihte faktin se Alfonsi V, dhe akoma më pak pasardhësi i tij Ferrante, nuk qe në gjendje të plotësonte detyrimin e tij kryesor prej kryezoti ndaj Skënderbeut, që kishte të bënte me sigurimin e mbrojtjes (*protectio*). Rreth 200 vjet më parë, mbretit Karl I Anzhu iu hapën portat e Shqipërisë, vetëm pasi premtoi të marrë në mbrojtje fisnikët shqiptarë. Ai mundi të shpallej “*rex Albaniae*” vetëm kur u premtoi krerëve shqiptarë se do t’i mbronte nga armiqtë dhe do t’i furnizonte me ndihma “ashtu siç i ka hije të veprojë një kryezoti të mirë në marrëdhënie me vasalët e tij” (*secundum quod bonus dominus suos*

<sup>23</sup> Antonius Guidobonus, i dërguar i Milanos në Venedik, letër princit Sforza, 18 shtator 1455: “*Schanderbecho, signore in Albania, e molto affectionato ad la Maestà predicta*”, shih: J. Radonić, *Đurađ Kastriot, Skenderbeg*, f. 56. Krhs. me letrën e Skënderbeut për mbretin Ferrante, 31 tetor 1460, ku ai i trajton marrëdhëniet e tij me Alfonsin si marrëdhënie mes miqsh e të afërmish: “*Pessima natura me pare de quelli homini, che vedono loro Sig<sup>ri</sup> parenti o amici conosciuti in alcuna necessità, che spectano essere pregati o recercati*”. Shih gjithashtu letrën e Skënderbeut për princin Giovanni Orsini, 31 tetor 1460: “*quello sancto et immortale Re de Aragona, del quale io nè nullo de li mei vassalli ni potemo recordare senza lacrime*”. J. Radonić, *Đurađ Kastriot, Skenderbeg*, f. 120. Nga ana e tij mbreti Ferrante i drejtohej zakonisht Skënderbeut “*tamquam pater carissimus*”, pra, si “një babai të dashur”, G. M. Monti, *La spedizione in Puglia*, f. 34, 39, 40, 41. Shih dhe: M. Barleti, *Histori e Skënderbeut*, f. 284, 314, 397, 418-421.

<sup>24</sup> J. Radonić, *Đurađ Kastriot, Skenderbeg*, f. 33. Pak më vonë, Senati deshi të tregojë zemërgjerësinë e vet ndaj të rekomanduarit të vet, shqiptarit, Stefan Cërnojeviq, të cilit i dhuroi “*unum pannum de auro*”, J. Radonić, *Đurađ Kastriot, Skenderbeg*, f. 38. Krhs. M. Barleti, *Histori e Skënderbeut*, f. 284.

<sup>25</sup> M. Bloch, *La servitù nella società medievale*, Firenze: 1975, 2, f. 234-239.

*vassallos iuvare consueverit*)<sup>26</sup>. Nuk është vendi këtu të tregojmë se sa dhe si e përmbushi Karli I këtë obligim feudal. Por, me siguri mund të themi, që pasardhësi aragonez i tij, Alfonsi V, nuk mundi ta përmbushë një obligim të tillë prej kryezoti, të marrë solemnisht në Traktatin e Gaetës kundrejt Gjergj Kastriotit. E pra, dy kapitujt e parë të Traktatit të Gaetës e angazhonin mbretin që të dërgonte trupa të konsiderueshme në Shqipëri, me kontributin e të cilave do të mbroheshin kështjellat ende të lira dhe jo vetëm, por do të rifitoheshin edhe kështjella e territore tashmë të pushtuara nga osmanët<sup>27</sup>. Por, angazhimi konkret i napolitanëve në terren filloi në një mënyrë aspak inkurajuese. Ekspedita e parë, që duhej të përfaqësohej nga vetëm 200 këmbësorë, u reduktua edhe ashtu në vetëm 100 syresh<sup>28</sup>. Pra, një prezantim i palavdishëm i një sovranit përpara një vasali të premtuar. Kontributi i sovranëve të Napolit për qëndresën antiosmane në Shqipëri edhe më tej mbeti në nivel simbolik, dhe vetë Alfonsi V dukej se nuk e kishte ndërgjegjen të qetë kur, në një rast, u detyrua t'i pohojë Skënderbeut se e dinte mirë edhe ai vetë që ndihmat që po i dërgonte Heroit Shqiptar nuk ishin aspak të mjaftueshme për të përballuar ushtritë e mëdha të osmanëve (*nostrum auxilium non id esse, quod sibi adversus tantum exercitum sufficere videatur*)<sup>29</sup>.

Në kushte të tilla, ishte krejt e pamundur të vendosej një lidhje e ngushtë e tipit feudal midis Alfonsit të Napolit dhe Skënderbeut. Nga njëra anë, ky ishte tepër i fortë dhe i pavarur, për t'u kthyer në një "njeri" (*homo*) të sundimtarëve të Napolit. Nga ana tjetër, përkundrejt pamundësisë së këtyre të fundit për të qenë "kryezotë të mirë", pra për t'i siguruar mbrojtjen vasalit të vet në nevojë, Skënderbeu e kuptoi shumë shpejt se do të ishte vetëvrasëse të mbështetej vetëm ose kryesisht tek ndihma e napolitanëve. Ndaj, iu vu punës për të vendosur lidhje edhe me sovranë e princër të tjerë të Italisë e të Evropës<sup>30</sup>. Por, për t'u theksuar është, që si Alfonsi, ashtu edhe djali e trashëgimtari i tij Ferrantja, u angazhuan për t'i siguruar Skënderbeut protektorë të tjerë veç vetes, në mënyrë që t'i përfshinin ata në qëndresën antiosmane të Heroit

<sup>26</sup> *Acta et diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia*, L. Thalloczy-C. Jireček-M. Šufflay (Hrsg.), vëll. I, Wien: 1913, nr. 269.

<sup>27</sup> J. Radonić, *Durađ Kastriot, Skenderbeg*, f. 23.

<sup>28</sup> *Po aty*, f. 22, 26-27.

<sup>29</sup> *Po aty*, f. 22, 27.

<sup>30</sup> F. Pall, "I rapporti italo-albanesi intorno alla metà del secolo XV...", f. 125, 126.

Shqiptar<sup>31</sup>. Dhe kështu, duke shpërndarë horizontalisht copëza të rëndësishme të sovranitetit të tyre të pretenduar mbi Skënderbeun, tek fuqitë e tjera, si tek Papati, Milanoja, Firencja, Pisa, Mantova, Venediku etj., mbretërit e Napolit thjesht deklarorin pafuqinë e tyre. Sovraniteti i ndarë (i participuar) përmbyste vetë kuptimin e institucionit të vasalitetit, përderisa Heroi Shqiptar, në vend që të ishte “njeriu i një zotërie”, d.m.th. i Alfonsit, kthehej në “njeriun e shumë zotërinjve”, d.m.th. të asnjërit.

Në çdo rast, si Alfonsi V, ashtu edhe pasardhësi i tij, Ferrante, nuk qenë në gjendje të ndikonin veprimtarinë ushtarake e politike të Skënderbeut, që në këtë lëmë sillej në mënyrë krejtësisht të pavarur. Kështu, ndonjë vit pas nënshkrimit të Traktatit të Gaetës, në 1452, Skënderbeu i ofroi në mënyrë të njëanshme ndihmë ushtarake “vullnetare e të papaguar” (*sponte...sine ullo premio*) Republikës së Venedikut, me të cilën Alfonsi i Napolit ishte në marrëdhënie konfliktuale<sup>32</sup>. Vetëdija e varësisë së fateve të Republikës së Venedikut nga qëndresa antiosmane e shqiptarëve, i jepte të drejtën Skënderbeut të sillej herë-herë me autoritetin e një sovrani, siç veproi në vitin 1460, kur i kërkoi në mënyrë ultimative Venedikut që të prishte marrëveshjen e paqes që ky sapo kishte lidhur me turqit<sup>33</sup>. Skënderbeu, pra, nuk ishte i lidhur nga asnjë klauzolë, që në marrëdhëniet me të tjerë të ndiqte vullnetin e Alfonsit, siç duhej të ndodhte nëse vërtet do të kishte qenë vasal i të parit. Nuk ndodhte kështu, p.sh., me Gjergj Arianitin. Në marrëveshjen e njëkohshme të këtij me Alfonsin, përcaktohej qartë se Arianiti detyrohej

<sup>31</sup> J. Radonić, *Đurađ Kastriot, Skenderbeg*, f. 39-40, 58-60.

<sup>32</sup> Vendim i Senatit, datë 28 shtator 1452: “*Magnificus Scanderbegus sponte se obtulit ad servicia nostra cum persona et gentibus suis sine ullo premio*”, shih: Giuseppe Valentini, *Acta Albaniae Veneta saeculorum XIV et XV*, pj. III, vëll. 21, München: 1975, nr. 5894; J. Radonić, *Đurađ Kastriot, Skenderbeg*, f. 38.

<sup>33</sup> J. Radonić, *Đurađ Kastriot, Skenderbeg*, f. 170, 180. Senati i Venedikut duket se u prek në sedrën e tij nga kjo ndërhyrje pa takt e heroit shqiptar (*de quanto vni ne scriveti de la pratica de la pace cum el Turco, ve certificamo, che le astutie del Turco a nui sono notissime..ringraciemovi niente manco de lo avizio datoci e de la dichiarita vostra opinione*). Megjithatë, Senatit iu desh t’i justifikonte traktativat për paqe me osmanët, dhe këtë e bëri në një mënyrë jo fort dinjitoze: Venediku nuk mund ta shmangte paqen, pasi kjo... ishte prirje natyrale e tij (“*ex naturali inclinatione nostra nesciremus recusare pacem*). Një përligjeje e tillë tingëllon poshtëruese për vetë Republikën, e cila deri atëhere ishte përpjekur ta nxiste Skënderbeun kundër osmanëve. Shih: J. Radonić, *Đurađ Kastriot, Skenderbeg*, f. 170.

“të bënte luftë dhe paqe sa herë që këtë do ta dëshëronte Madhëria e Tij” (*fare guerra e pace ad omne voluntà de ipsa Maestà*)<sup>34</sup>. Përkundrazi, në Traktatin e Gaetës mes Alfonsit e Skënderbeut, nuk ka gjurmë të një pretendimi të tillë prej sovrani nga ana e mbretit kundrejt Kastriotit. Në të 25 vjetët e epopesë së tij, Skënderbeu vendosi në pavarësi të plotë për çështje që kishin të bënin me luftën dhe me paqen.

Ndërkohë, dihet se pas vdekjes së Alfonsit V në 1458, trashëgimtari i tij, mbreti Ferrante, nuk ishte në gjendje të ushtronte asnjë autoritet prej kryezoti mbi Skënderbeun. Në të kundërtën, ishte Papati ai që me kalimin e kohës fitoi statusin e një pushteti epror, edhe pse më shumë moral, se sa real. Në këtë mënyrë, Skënderbeu iu drejtua pikërisht Papës Piu II, dhe jo mbretit Ferrante<sup>35</sup>, për të marrë miratimin për fushatën e tij ushtarake në Italinë e Jugut kundër feudalëve filoanzhuinë<sup>36</sup>. Po ashtu, në vitin 1460, Skënderbeu iu drejtua jo Ferrantes, që sipas së drejtës feudale duhej të ishte njëlloj kryezoti i tij si edhe i jati, Alfonsi, por iu drejtua Papës për t'i kërkuar këtij lejë për të përmbyllur një armëpushim me Sulltanin<sup>37</sup>. Vlen të saktësohet, se në të dy rastet e mësipërme, pavarësisht konsultimit formal, Skënderbeu mori vendime krejtësisht të pavarura. Ai vendosi t'i shkojë në ndihmë mbretit Ferrante, që atë kohë ndodhej në vështirësi serioze, pasi, siç shprehej ai vetë, ndjehej i detyruar ndaj të jatit të tij, Alfonsit “*sancto et immortale Re d'Aragona*”<sup>38</sup>. Kurse, për sa i përket armëpushimit me turqit, pa e përfillur kundërshtimin e Papës<sup>39</sup>, Skënderbeu mori një vendim të pavarur dhe në fakt, e nënshkroi marrëveshjen përkatëse me turqit osmanë, duke zhgënjyer jo pak kreun e kishës katolike<sup>40</sup>.

<sup>34</sup> *Po aty*, f. 28.

<sup>35</sup> Kjo konfirmohet nga vetë Skënderbeu në letrën e tij për Ferranten, në vitin 1459. Shih: G. M. Monti, *La spedizione in Puglia*, f. 33.

<sup>36</sup> Daniele Farlati, *Illyricum Sacrum*, tomus 7, Venetiis, 1817, f. 422-423; F. Noli, *Gjergj Kastrioti Skënderbeu*, f. 306; K. Frashëri, *Skënderbeu, jeta dhe vepra*, f. 359, 367, 382.

<sup>37</sup> D. Farlati, *Illyricum Sacrum*, tomus 7, f. 423; F. Pall, *Marino Barlezio, uno storico umanista*, f. 79.

<sup>38</sup> G. M. Monti, *La spedizione in Puglia*, f. 31.

<sup>39</sup> “*romano Pontifici non convenire licentiam cuique dare, ut cum infidelibus paciscatur*”, D. Farlati, *Illyricum Sacrum*, tomus 7, f. 423.

<sup>40</sup> Oliver J. Schmitt, “Paul Angelus, Erzbischof von Durazzo und seine Bedeutung für den Türkenkampf Skanderbegs”, në: *Thesaurismata*, 30 (2000), f. 130, 151.

Nga ana tjetër, në mjaft raste Skënderbeu ndërmoi aksione politike e ushtarake, që e kapërcenin shumë hapin që i lejohej të hidhte një vasal i zakonshëm. Ashtu siç do të bënte çdo sundues i pavarur, në vitin 1463 Skënderbeu dërgoi në Tivoli (Romë) një delegacion, kreu i të cilit, Martin Muzaka, këshilltar e orator i tij, mbajti përpara Papës e kolegjit të kardinalëve një fjalim patetik mbi nevojën dhe urgjencën e organizimit të kryqëzatës antiosmane<sup>41</sup>. Një akt venecian i 18 marsit 1466 na bën të ditur se Skënderbeu po bënte atë kohë presion mbi Venedikun, në mënyrë që ta detyronte këtë të hiqte dorë nga ideja për të lidhur një traktat paqej me osmanët<sup>42</sup>. Veprimtaria e ethshme ushtarake e diplomatike e Skënderbeut nuk i shkonte fare për shtat një personazhi me statusin e vasalit. Nga ana tjetër, një njeri kaq i fuqishëm e aktiv, siç ishte Skënderbeu, nuk mund të ishte vasal i sundimtarëve të tillë, siç ishin ata të Napolit, të cilët ishin çvendosur në periferi të ngjarjeve dhe merreshin me vogëlsitë e përditëshme të mbretërimit të tyre.

Sipas kapitullit të dytë të Traktatit të Gaetës, i cili gjithashtu mbeti në letër, ato territore që do të çliroheshin me ndihmën napoletane, fillimisht do t'i dorëzoheshin mbretit Alfons. Paskëtaj, një pjesë e tyre do t'i kthehej Skënderbeut në cilësinë e një feudi të vërtetë, me të drejtat e detyrimit përkatës<sup>43</sup>. Pikërisht nga kjo pikë e pazbatuar e Traktatit duhej të lindte raporti i ri feudal midis Skënderbeut dhe Alfonsit. Por, me disfatën e Beratit, më 1455, u shua përgjithmonë forca dhe ideja për kundërmësymje e Skënderbeut. Këtej e tutje, si rezultat i një raporti të pafavorshëm të forcave, ai u detyrua të mbajë një qëndrim thelbësisht mbrojtës. Në kushtet kur edhe ndihmat nga Napoli kishin shteruar, ai e pati krejt të pamundur ta zgjeronte territorin e tij përtej Shqipërisë së Mesme. Kështu, sovranëve të Napolit nuk iu dha rasti të merrnin në dorëzim territore të çliuara nga osmanët dhe t'i rikalonin një pjesë të atyre territoreve, si feud, në duart e Skënderbeut, siç ishte parashikuar në Traktatin e Gaetës. Një operacion i tillë do të sillte automatikisht lindjen e një raporti të vërtetë feudal kryezot-vasal mes kurorës së Napolit dhe

---

<sup>41</sup> Angelo Mercati, "Documenti veneziani sull'Oriente adriatico", në: *Orientalia Christiana Periodica*, 14 (1948), f. 166-169; F. Pall, *Marino Barlezio, uno storico umanista*, f. 82. Për këtë flet përmbledhtas edhe vetë Papa Piu II. Shih: Enea Silvio Piccolomini, *Commentarii rerum memorabilium*, Francofurti: 1614, f. 330.

<sup>42</sup> J. Radonić, *Durađ Kastriot, Skenderbeg*, f. 180.

<sup>43</sup> *Po aty*, f. 23.

Skënderbeut. Alfonsi e pasardhësit e tij nuk e patën rastin të krijonin prona në Shqipëri<sup>44</sup>. Për rrjedhojë, nuk mundën në asnjë rast të shpërndanin feude e të fitonin vasalë në tokën shqiptare. Pra, për Skënderbeun dhe të tjerë nuk ekzistonte asnjë detyrim formal, për të udhëtuar për në Napoli e për t'i paraqitur mbretit betimin dhe homazhin feudal, siç parashikohej në Traktatin e Gaetës<sup>45</sup>.

I pazbatuar e pa efekte praktike mbeti edhe kapitulli i Traktatit që trajtonte furnizimet me kripë të shtetit të Skënderbeut. Furnizimi me kripë ishte padyshim një nga treguesit e ushtrimit të sovranitetit feudal, dhe në Traktat përcaktohej qartë që Kastrioti duhej t'i furnizonte tregjet e shtetit të tij me kripë napoletane<sup>46</sup>. Por, oborri i Napolit nuk qe në gjendje të siguronte sasisë të duhura të kripës për tregjet shqiptare: mungonte prodhimi, por mungonin edhe anijet (*fustes vero hic habemus nullas*), për ta kaluar kripën në brigjet shqiptare<sup>47</sup>. Veç kësaj, Skënderbeu nuk ishte aspak i interesuar për një monopol napoletan të kripës. Kur Venediku u bë zot i qytetit të Durrësit, më 1392, një ndër masat e para të tij kishte qenë vendosja e monopolit të kripës dhe përmbyllja e marrëveshjeve të veçanta me krerët shqiptarë të hinterlandit, me anë të cilave këta detyroheshin të furnizoheshin me kripë vetëm nga depot (*fundici*) e Republikës në Durrës<sup>48</sup>. Jo thjesht për traditë, Skënderbeu detyrohej ta respektonte këtë klauzolë, kusht përcaktues i marrëdhënieve me Venedikun. Shuma prej 1400 dukatë ari, që prej 1448-ës ai merrte çdo vit nga Republika e Venedikut si provizion, nxirrej pikërisht nga taksa, që shtetasit e Skënderbeut paguanin për blerjen e kripës veneciane. Dhe autoritetet veneciane në Shqipëri, të cilat ndiqnin me vigjilencë

<sup>44</sup> Këtë e dinte mirë Papa Kalisti III, i cili, vendet shqiptare të pretenduara prej Alfonsit, i quante “vendet e Skënderbeut”, shih: J. Radonić, *Đurađ Kastriot, Skenderbeg*, f. 84. Nga ana e tij, Skënderbeu e konsideronte veten e tij, vendin dhe shtetasit e tij, si të lirë nga çdo lloj sovranitet napoletan, siç e shprehte hapur edhe në vitin 1463, kur vuri në dispozicion të Papës Piu II dhe të Kryqëzatës “*nos et personam nostram et omnia bona nostra ac terras, castra, villas, fortelicia, armigeros, subditos et homines nostros*”, shih: G. Mercati, *Documenti veneziani sull' Oriente adriatico*, f. 167.

<sup>45</sup> K. Biçoku, *Për Skënderbeun*, f. 283.

<sup>46</sup> J. Radonić, *Đurađ Kastriot, Skenderbeg*, f. 23.

<sup>47</sup> *Po aty*, f. 27, 39.

<sup>48</sup> Luan Malltezi, *Qytetet e bregdetit shqiptar gjatë sundimit venedikas 1392-1478*, Tiranë: 1988, f. 62-63; Oliver J. Schmitt, *Arbëria Venedike (1392-1479)*, Tiranë: 2007, f. 337-345.

marrëdhëniet e Skënderbeut me napoletanët, nuk munguan t'ia kujtonin Heroit Shqiptar se për të patur 1400 dukatët, duhej të respektonte monopolin venecian të kripës<sup>49</sup>.

Së fundi, dy fjalë për kapitullin përmbyllës të Traktatit të Gaetës, i cili meriton një vështrim të veçantë. Në dijeninë tonë, deri më sot ka munguar një analizë e hollë mbi përmbajtjen, për rrjedhojë nuk është kapur rëndësia e këtij kapitulli në pikëpamje të së drejtës dhe të precedentëve historikë të tij<sup>50</sup>. Dallimi në raport me kapitujt e tjerë të Traktatit bie menjëherë në sy të lexuesit. Këtu është mbreti Alfons që merr një detyrim solemn kundrejt palës tjetër. Premton, në fakt, se “do të ruajë e do të respektojë të gjitha privilegjet e qytetit të Krujës e të gjithë Arbrit, siç kanë vepruar të gjithë sovranët e Arbërisë, si dhe do të marrë në mbrojtje të gjithë ata zotërinj që do të pranojnë t'i nënshtrohen mbretit në fjalë, duke u konfirmuar atyre si dhe vetë qytetit të Krujës, të gjitha privilegjet përkatëse” (*mantenire et servare tucti li privilegi dela cita de Croya et de tucta Albano, como hanno facto tucti li Re de Albania, et mantenire tucti li Signori, che saranno subiecti a la predicta M<sup>ta</sup> et confirmare tucti loro privilegi, tanto a la dita cita, quanto ad tucti li Signori*)<sup>51</sup>. E thënë shkurt, me këtë klauzolë Alfonsi heq dorë nga zbatimi i së drejtës feudale të Mbretërisë së Napolit në Shqipëri (Arbër).<sup>52</sup> Përkundrazi, ai shpall se njihte dhe linte në fuqi edhe paskëtaj të drejtat e privilegjet feudale që i ishin akorduar më parë qytetit të Krujës dhe bujarisë shqiptare nga zotër të tjerë të huaj. Në zbatim të këtij kapitulli të Traktatit, në 19 prill 1457, mbreti Alfons nxorri një privilegj të posaçëm, me të cilin i konfirmonte klerit, bashkësisë dhe qytetarëve të veçantë të Krujës “ato privilegje e liri, që ua kishin konfirmuar atyre njëri pas tjetrit perandorët e dikurshëm” (*privilegia quaedam et libertates ab antiquis*

<sup>49</sup> Dogji Giovanni Foscari, letër të dërguarit të vet pranë Skënderbeut, 13 mars 1455: “*quod caravane et homines illarum partium veniant ad accipiendum de sale nostro et ad conducendum de rebus et mercationibus suis ad terras et loca nostra, ex quibus, sicut scit, suam provisionem habere debet, quoniam deficientibus introitibus nostris illarum civitatum, non posset habere pecunias sue provisionis*“, J. Radonić, *Đurađ Kastriot, Skenderbeg*, f. 50.

<sup>50</sup> K. Frashëri, *Skënderbeu, jeta dhe vepra*, f. 315-316; K. Biçoku, *Për Skënderbeun*, f. 303-315; O. J. Schmitt, *Skënderbeu*, f. 279-305.

<sup>51</sup> J. Radonić, *Đurađ Kastriot, Skenderbeg*, f. 23.

<sup>52</sup> P. Xhufi, *Dilemat e Arbërit*, f. 17-23.

*imperatoribus eisdem successive refirmatis*)<sup>53</sup>. Këta perandorë të dikurshëm nuk ishin tjetër veç perandorët e Bizantit: në fakt, teksti i privilegjit të Alfonsit përfshin edhe privilegjet e mëparshme të perandorëve bizantinë Manuel I Komnen, Andronik II Paleolog dhe të car Stefan Dushanit të Serbisë, të cilët në dokument përmenden me emër.

Në krahasim me kapitujt e tjerë, të cilët më së shumti bëjnë fjalë për situata virtuale, ky është kapitulli i vetëm që i përgjigjet një gjendjeje reale. Aty bëhet fjalë pikërisht për parimin e vetëqeverisjes, që kishte rregulluar marrëdhëniet e shqiptarëve me sovranët e huaj që prej kohëve të hershme. Në shek. XI, Michael Ataliati na kumton qartë se marrëdhëniet e shqiptarëve me Perandorinë Bizantine rregulloheshin mbi bazë të regjimit të *izopolitisë* (ἰσοπολιτεία), që ishte trashëguar qysh prej kohës së lashtë. Në një rast tjetër<sup>54</sup> kemi treguar se regjimi i izopolitisë nënkuptonte njohjen formale të autoritetit suprem të Perandorit Bizantin, kundrejt një autonomie të gjerë politike, administrative e fiskale, që shprehej në çlirimin nga taksat e detyrimet e tjera, me përjashtim të detyrimit për të luftuar në krah të Bizantit (*pro Romania pugnare*).<sup>55</sup> Gjithsesi, ky detyrim ushtarak i shqiptarëve në favor të Bizantit, nuk rridhte nga një raport varësie, suditance apo e thënë ndryshe vasaliteti, por, siç e pohon shkoqur Ataliati në shek. XI, nga një raport aleance ushtarake (σύμμαχία)<sup>56</sup>. Në këtë mënyrë, sistemi bizantin i izopolitisë, kujton sistemin më të hershëm të federatës (*foedus*), që rregullonte marrëdhëniet e Perandorisë Romake me popujt e tjerë.

*Izopolitia* bizantine, e cila nënkuptonte ruajtjen e identitetit e të autonomisë brenda kuadrit të Perandorisë, karakterizoi edhe më vonë marrëdhëniet e shqiptarëve me sovranë të ndryshëm të huaj. Sado autoritar që të ishte, në vitin 1272, Karli I Anzhu u detyrua t'u

<sup>53</sup> J. Radonić, *Durađ Kastriot, Skenderbeg*, f. 79-81.

<sup>54</sup> P. Xhufi, "La debizantinizzazione dell' Arbanon", në: *The mediaeval Albanians*, International Symposium 5. Athens: Institute for Byzantine Research, 1998, f. 60-63.

<sup>55</sup> Th. Tafel-G. Thomas, *Urkunden zur älteren Handels- und Staatsgeschichte der Republik Venedig*, Wien, 1856, f. 116. Mes shek. XI-XII Venediku dhe Ankona patën gjithashtu një marrëdhënie isopolitie me Bizantin. Shih: P. Xhufi, *Dilemat e Arbërit*, f. 54-55.

<sup>56</sup> M. Attaleiates, *Historia*, Bonnae, ed. J. Bekker, 1853, f. 9: "Ὁὐ μὴν δὲ ἀλλὰ καὶ οἱ ποτε σύμμαχοι καὶ τῆς ἰσοπολιτείας ἡμῖν συμμετέχοντες, ὡς καὶ αὐτῆς τῆς θρησκείας Ἀλβανοὶ καὶ Λατῖνοι ὅσοι μετὰ τὴν ἑσπερίαν Ῥώμην τοῖς Ἰταλικοῖς πλησιάζουσι μέρεσι".

rikonfirmonte krerëve shqiptarë *omnia privilegia eis concessa ab antiquis imperatoribus Romanie et omnes bonos usus et consuetudines eorum*<sup>57</sup>. Kjo klauzolë, që ndeshet në marrëveshjen e Karlit I Anzhu me krerët shqiptarë, në 1272, që përsëritet në marrëveshje të ngjashme të mbretërve e princërve të tjerë anzhuinë me shqiptarët, më 1304, 1336 e 1338<sup>58</sup>, përfshihet *tale-quale*, edhe në Traktatin e Gaetës të vitit 1451 mes Alfonsit V dhe Skënderbeut, apo edhe në privilegjet për qytetin e Krujës, shpallur prej tij në 1457<sup>59</sup>. Me njohjen e privilegjeve, dhe pra të statusit, që shqiptarët kishin gëzuar që nga kohët e Perandorisë Bizantine, Alfonsi V, ashtu si edhe paraardhësit e tij Anzhuinë, praktikisht hiqte dorë nga vendosja e një marrëdhënie të vërtetë feudale kryezot-vasal me Skënderbeun e me princërit e tjerë të Shqipërisë, ashtu siç do ta kishte kërkuar në fakt e drejta feudale napoletane.

---

<sup>57</sup> *Acta et Diplomata*, I, nr. 269. Akoma më shumë, Karli I u detyrua t'u njohë krerëve shqiptarë edhe të drejtën, që feudet e tyre t'i administronin, jo sipas së drejtës feudale napoletane, por "sipas detyrimeve, praktikave e zakoneve të Perandorisë Bizantine" (*sub servitiis, usibus et consuetudinibus Imperii Romanie*).

<sup>58</sup> Krahaso me paktet e nënshkruara në Durrës, në vitin 1336, midis Luigjit Anzhu dhe despotit Gjini Muzaka, ku anzhuinët angazhoheshin të respektonin "të gjitha praktikat e mbretërisë së Arbërisë, ashtu siç ua kishin konfirmuar atyre njëri pas tjetrit të gjithë perandorët, që kishin sunduar mbi bazën e privilegjeve të vjetra të perandorëve më të hershëm dhe të dëshmive të tjera të duhura" (*omnes consuetudines regni prefati Albanie...confirmatas vobis ab imperatoribus successive, ut pretenditis, qui fuerunt et regnarunt pro tempore per antica privilegia imperatorum ipsorum aut alias cautelas ydoneas*), shih: *Acta et Diplomata*, I, nr. 808.

<sup>59</sup> *Acta et Diplomata*, I, nr. 300. Atë kohë Anzhuinët u detyruan të konfirmojnë edhe në More zakonet e vjetra, privilegjet e perandorëve bizantinë dhe të drejtat feudale bizantine, shih: D. Jacoby, *La féodalité en Grèce médiévale. Les Assises de Romanie*, Paris: 1971, f. 35-36, 52, 55.

*S u m m a r y*

## SKËNDERBEG AND ALFONS V OF NAPLES: A VASSAL OR AN ALLY?

This paper deals with a debated issue regarding the claimed vassality Scanderbeg had to the king of Naples, Alfons V. After analyzing in details the Treaty of Gaeta which was signed between the two rulers in 1451, and also based on the correspondence of Scanderbeg with Pope Pius II and the successor of Alfons, king Ferrante of Naples, it is concluded that between Scanderbeg and king Alfons there has not been a pure vassality relation. The Treaty of Gaeta foresaw that Gjergj Kastrioti Scanderbeg would become a vassal of Alfons, after the latter would free with his army the Albanian territories invaded by the ottomans, which afterwards would be handed to Scanderbeg as his feudal lands. Only after this Scanderbeg would go to Naples to take the feudal oath and officially become a vassal of Alfons. In fact, the attempt of Alfons to free the Albanian territories from the ottomans failed once and forever in Berat, in 1455. Therefore, the main prerequisite to achieve vassality was not fulfilled. On the other hand, in Gaeta, king Alfons promised to supply with salt the markets of Kastriot. This was a tribute of the feudal lord towards his vassal, but this engagement was not fulfilled as well. Thus another prerequisite which would ensure the vassality relation between the two Adriatic shores was not achieved. Scanderbeg's expedition in Pulia in 1463 does not show that this was a feudal obligation towards the kings of Naples. The letters that Scanderbeg sent to the Pope and to king Ferrante, the successor of Alfons, prove that he went to assist Ferrante not asked by the latter but simply because he had been a friend and admirer of his father.

However, a vassality relation was established between Scanderbeg and king Ferrante of Naples when the latter gave to the Albanian hero the lands of Monte Sant'Angelo and San Giovanni Rotondo in Gargano. But this feudal relation was valid for the Italian territories that Scanderbeg owned. Thus, there were the heirs of Scanderbeg who became vassals to the crown of Naples, when they left Albania and settled in their territories in Naples.